



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural



Raport i punës

Gjashtëmujori i parë/2026



Përmbajtja

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	3
Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars.....	3
Aktivitetet në muajin janar	3
Aktivitetet në muajin shkurt.....	4
Aktivitetet në muajin mars	5
Aktivitetet në periudhën: prill, maj, qershor.....	5
Aktivitetet në muajin prill.....	5
Aktivitetet në muajin Maj.....	6
Aktivitetet në muajin Qershor	7
Projektet e investimeve kapitale	8
Rregullimi i Rrugëve Fushore.....	8
Pastrimi i Përrenjëve	8
Kanalet Kulluese	8
Serrat	9
Depo Bujqësore	9
PËRFUNDIM	9

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2026, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vete aktivitete të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars


Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitete.

Aktivitetet të cilat kryhen vazhdimisht, siq janë pranimi dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët, si dhe shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si: vërtetim për fermer që dëshmon se janë prodhues bujqësorë, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë etj.

Ndërsa aktivitetet më kryesore paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.



Aktivitet në muajin janar

- Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranimi i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025 për fermerët blegtor (MBPZHR), hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë. Kjo thirrje ka qenë e hapur nga: **15 janar deri më 27 shkurt 2026**.
- Gjithësej kanë aplikuar 90 blegtorë, prej tyre:
 - 76 fermerë kan aplikuar për qumësht me gjithsej: **1.976,307** litra qumësht.
 - 19 prej tyre janë aplikues për viqa me gjithsej **299** krerë të viçave për majmëri
 - 1 fermer për brojlerë me **53054** copë
 - 1 fermerë për therje me **126** krerë.
- Vlerësimi i punëtorëve për vitin 2025
- Pranimi i kërkesave të ndryshme, kryesisht për rregullimin e rrugëve fushore, ndërrim destinime, nifa.
- Pas kërkesave të shumta për dëme, zyrtarët e DBPZHR-së që kanë qen pjesë e Komisioneve për vlerësimin e dëmeve kanë dalur në terren për vlerësimin e tyre.
- Vlera e Dëmeve në Bujqësi sipas kërkesave ka qenë **165,178.64€**.



Aktivitetet në muajin shkurt

- E kemi shpallur thirrjen publike për aplikim për të gjitha bizneset që merren me grumbullimin dhe përpunimin e perimeve, kryesisht të Trangullit Kornishan dhe specit që kanë të siguar treg për shitjen e këtij produkti. Përmes kësaj marrëveshje do të mbulohen: Fidanet cilësore të trangullit, Plehërimi dhe Riplehrimi (kristalorët), Pesticidet, Mulqerimi (Folia e zezë), Sistemi i ujitjes pikë-pikë. Thirrja ka qenë e hapur nga **27.02.2026** deri më **13.03.2026**.
- Poashtu është formuar komisioni dhe është publikuar vendimi për përfituesin, si dhe është nënshkruar kontrata.




- Veterinari i punësuar në DBPZHR, ka vaksinuar bagëtitë falas për të parandaluar sëmundjet infektive, Janë vaksinuar gjithsej **2126** bagëti të trasha me vaksinën Cubolac, pas përfundimit të vaksinimit të bagëtitë të trasha do të fillojë vaksinimi edhe i bagëtitë të imta.




- Komisioni i formuar për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës ka dalur në terren, dhe e ka përfunduar raportin për të gjithë fermerët që kanë në shfrytëzim këto prona.
- Pranimi i kërkesave të ndryshme, kryesisht për rregullimin e rrugëve fushore, ndërrim destinime, nifa.

- Kemi vizituar fermerë të ndryshëm, stalla, fidanishte, serra, pika grumbulluese etj.



Aktivitetet në muajin mars

- Gajtë muajit mars është hapur thirrja: Përkrahja e Fermerëve me Pleh Artificial. Thirrja ka qenë e hapur nga 02.03.2026 deri më 19.03.2026. Gjithsej kanë aplikuar 1146 fermerë.
- Është formuar komisioni i cili e ka kryer vlerësimin e aplikacioneve.



Aktivitetet në periudhën: prill, maj, qershor

Aktivitetet në muajin prill

- Kemi pranuar dy kërkesa për ndërrim destinim të tokës bujqësore janë dhënë leje për ndërtimin e parkut solar të energjis, si dhe janë realizuar të hyrat në buxhetin e Komunës.
- Kemi pranuar disa kërkesa për rregullimin e rrugëve fushore, në Ratkoc, Xërxe, Malësi etj, ju kemi kthyer përgjigje të gjithave.
- Kemi vizituar Agrocelinën për të parë më afër shpërndarjen e materialit tek fermerët të cilët kanë kontratë me Komunën. Ky projekt përfshin shpërndarjen e sistemit të ujitjes, plehut kristalor, pesticideve si dhe materialeve të tjera të nevojshme për sera.

Në këtë iniciativë, Drejtoria e Bujqësisë subvencionon fermerët me 80%, ndërsa kompania Agro Celina kontribuon me 20%. Në kuadër të këtij projekti do të mbështeten gjithsej 150 fermerë, duke përfituar rreth 500,000 fidane, të cilat do të mbillen në një sipërfaqe prej 12 hektarësh. Prej tyre, 7 hektarë do të mbillen me tranguj, ndërsa 5 hektarë me specia kërtosk.



Pa vlerësimin e aplikacioneve nga komisioni, fermerët të cilët kanë plotësuar kriteret e parapara sipas thirrjes për aplikim me nr. të Prot. 1025 të datës 02.03.2026, janë shpallur përfitues të plehut pas verifikimit në programin Elpis të Subvencioneve për vitin 2025. Gjithsej janë 1130 përfitues të plehut, dhe janë ndarë në dy faza, fillimisht është bërë publike lista e fazës së parë, të cilët janë njoftuar për kryerjen e participimit prej 20%.



Aktivitetet në muajin Maj

Plehu Artificial

Kemi vazhduar me participimin e pagesave të plehut artificial si dhe kemi bërë shpërndarjen e plehut artificial, gjithsej 423 fermerë janë furnizuar me pleh nga lista e fazës së parë.

- Gjatë muajit maj e kemi publikuar edhe listën e fazës së dytë me 700 fermerë përfitues, të cilët e kanë kryer participimin prej 20% dhe janë furnizuar me pleh artificial.

Vaksinimi

- Veterinari i punësuar në DBPZHR, ka vaksinuar bagëtitë falas për të parandaluar sëmundjet infektive, Janë vaksinuar gjithsej 7320 bagëti të imta me vaksinën Cubolac

Cikadia

- Gjatë muajit maj është hapur thirrja: "Përkrahja e fermerëve me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" dhe trajtim me dron në vreshtat e hardhisë së rrushit" Thirrja ka qenë

e hapur nga 18.05.2026 deri më 01.06.2026 mirëpo është bërë zgjatja e afatit, për shkak të problemeve teknike të sistemi i lëshimit të vërtetimit të tatimit në pronë. Afati për aplikim është zgjatur deri më 12.06.2026. Gjithsej kanë aplikuar **311** fermerë të cilët janë furnizuar me preparat.

Aktivitetet në muajin Qershor

Thirrje Publike

- Kemi shpallur thirrjen publike për OJQ-t për organizimin e festivaleve Hardh Fest dhe Agrofesta, Afati për aplikim ka qenë nga data 18.06.2026 deri më 02.07.2026.

Subvencionet 2026

- Është hapur thirrja për aplikim për subvencione 2026, afati i aplikimit: **22.06.2026** deri me datë **21.07.2026**.
- Është kryer mobilizimi i zyreve në Krushë të Madhe dhe Ratkoc për evitimin e fluksit të numrit të madh të fermerëve.
- Hapja e userave për zyrtarët të cilët kanë pranuar aplikacione të bujqve.

Qentë Endacak

Kanë përfunduar të gjitha fazat tenderuese, është nënshkruar kontrata dhe shumë shpejt do të fillojë trajtimi i qenve endacakë.

Projektet e investimeve kapitale

Rregullimi i Rrugëve Fushore

Janë rregulluar këto rrugë fushore:

Sanimi i rrugëve fushore në fshatin **Polluzhë**, në lokacionin “Livadhet e Morinëve”,

Sanimi i rrugëve fushore në fshatin **Drenoc**, te Kroi i Demirit, si dhe në rrugën Zhagavica.

Sanimi i rrugëve fushore në rrugët e vreshtave në **Rahovec** në zonat **Hamoc dhe Berrnjak**, ku gjendja ka qenë e vështirë dhe në disa raste rrugët të pakalueshme.

Sanimi i rrugëve fushore në fshatin **Celinë**.

Sanimi i rrugëve fushore në fshatin në fshatin **Radostë**.

Pastrimi i Përrenjëve

Punimet janë zhvilluar në fshatin **Zaqisht**, ku ekipet në terren e kanë kryer pastrimin e shtratit të përrenjve, me qëllim të mirëmbajtjes së rrjedhës së ujërave dhe parandalimit të vërshimeve.

Punimet janë zhvilluar në fshatin **Xërxë**, ku ekipet në terren kanë kryer pastrimin e shtratit të përrenjve, me qëllim të mirëmbajtjes së rrjedhës së ujërave dhe parandalimit të vërshimeve.

Kemi realizuar punimet në **Rahovec** rrugës për **Brestovc**, ku është bërë pastrimi i një përrua që ishte bllokuar nga mbeturinat dhe ujërat e zeza.

Në kuadër të projektit për pastrimin e përrenjve dhe kanaleve të kullimit të tokave bujqësore, Drejtoria e Bujqësisë e Komunës së Rahovecit ka intervenuar edhe në kanalin e kullimit në fshatin **Celinë**.

Kanalet Kulluese

Pas reshjeve të fundit dhe grumbullimit të ujit në tokat bujqësore në fshatin **Xërxë**, Ekipet tona në terren kanë intervenuar me mjete dhe mekanizëm për pastrimin e kanaleve kulluese dhe hapjen e rrjedhës së lirë të ujit, me qëllim parandalimin e dëmeve në kulturat bujqësore dhe rikthimin e kushteve normale për punimin e tokës.

Kemi punuar në pastrimin e kanalit të kullimit në fshatin **Fortesë**.

Kemi intervenuar në kanalin e kullimit ndërmjet fshatit **Fortesë** dhe fshatit **Celinë**.

Kemi punuar në pastrimin e kanalit të kullimit në fshatin **Senoc** si dhe janë rregulluar 3 ura (me gypa fi 1200).

Serrat

Kanë përfunduar të gjitha fazat tenderuese, është nënshkruar kontrata, ka mbetur të hapet vetëm thirrja publike për aplikim.

Depo Bujqësore

Janë duke vazhduar punimet

PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Zyrtarët kanë qenë të gatshëm për çdo vlerësim dëmi me të cilët fermerët e komunës sonë ballafaqohen, ata dalin në terren në qdo fatkeqësi natyrore që ndodh dhe dëmton kulturat bujqësore.

Zyrtarët ju dalin në ndihmë fermerëve për çdo kërkesë të tyre, duke komunikuar me ta dhe duke mos hezituar.

03.07.2026

Rahovec

DREJTORI I DBPZHR-së

Behar Thaqi

